



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100557/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë nr. 5 Kamëz.*

Drejtuar: **Z. Altin LILA**
Shef i Komisaratis nr. 5

KAMËZ

Për dijëni: **Z. Rebani JAUPAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

TIRANË

I nderuar Z. Lila,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 i ligjit nr.81 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë nr. 5 Kamëz.

Inspektimi u krye në datën 24.03.2021, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e komisariatit z. Altin Lila dhe shefin e rendit z. Ylli Çollaku, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Lila informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë së këtij Komisarati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit, të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë. Theksojmë se, shefi i komisariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij komisariati.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjatë inspektimit të zyrave të punonjësve të Komisarati të Policisë nr.5, Kamëz, nuk u konstatuan sende apo mjete të cilat mund të ekspozonin dhunë apo elementë për Trajtim Çnjerëzor dhe Denigrues.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjëndja faktike e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e Institucionit të Avokatit Popullit, si më poshtë vijon:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e sistemit të ngrohjes me kaldajë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarati të Policisë nr.5 Kamëz dhe vënien e tij në funksionim në periudhën e dimrit, sipas kërkesave të aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”, dhe Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.925, datë 18.07.2019.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit dhe sigurisë në këtë Komisarati, si dhe krijimin e zyrave të përshtatëshme, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit, të monitorimit me kamera në këto zyra.

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për instalimin në dhomat e sigurisë të sistemit (buton dhe zile) për njoftimin e punonjësve të policisë nga të arrestuarit/ndaluarit në rast nevojë dhe vendosjen e aparatit telefonik fiks dhe citofon në korridorin e ambientit të sigurisë, për t'u përdorur nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Grupi i inspektimit u informua nga drejtuesit e institucionit edhe për veprimtarinë administrative të kërkesave të këtij institucioni drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, lidhur me instalimin e kamerave dhe për përshtatjen e mjediseve të dhomave të shoqërimit apo të sigurisë në mënyrë dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin e personave të shoqëruar, ndaluar apo të arrestuar, sipas kërkesave të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, por nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”, në ambiente me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur.¹

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së Komisarariatit. Në institucion kishte 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara me vete, një dhomë për qëndrimin e personave të rritur, një dhomë për qëndrimin e femrave dhe një dhomë për mbajtjen dhe shoqërimin e të miturve, me dimensione 5x4m². Dhomat ishin me hapësira të bollshme dhe me dritare të cilat siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, por kishte ndriçim edhe nga rrjeti elektrik dhe ato ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolina, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Kapaciteti i ambienteve ishte deri në 9 persona, ku secila dhomë kishte kapacitet deri në 3 persona të shoqëruar në konflikt me ligjin.

Dhomat ishin të pajisura me dyer druri të veshura me llamarinë dhe mbylleshin nga jashtë me shul dhe çelës. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera të Komisarariatit nuk kishin sistem ngrohjeje qendror. Ato nuk ishin të lyera dhe nuk ishin në kushte të mira higjienike. Dhoma e cila përdorej për të shoqëruar femra ishte e pajisur me tualet brenda, ndërsa për të shoqëruar meshkujt madhorë dhe të mitur përdorej tualeti i cili ndodhej në korridorin e ambientit të shoqërimit. Tualetet kishin ujë të rrjedhshëm gjatë 24 orëve, por ato paraqisnin probleme nga ana higjieno-sanitare dhe kishin nevojë për larje, lyerje dhe dezinfektim të herë pas herëshëm të tyre.

¹ Kreu VI, pika 3/d e procedurave standarde. “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga verifikimi i regjistrave për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar, fashikujt e dosjeve, që mbaheshin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e sigurisë, si dhe intervista e bërë me personin e ndaluar në mjediset e këtij institucioni, rezultoi se ka qenë konform akteve ligjore dhe nenligjore për këtë qëllim.

Në Komisaratin e Policisë nr.5 Kamëz, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 24.03.2021 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evindetuar në rregjistrin e shoqërimit **139** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na informuan se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre.

Nga verifikimi i regjistrin të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënime në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2021 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Në këtë Komisarariat nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim në të gjitha ambientet e këtij institucioni. Mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të komisarariatit nr. 5, Kamëz, Tiranë, përveç atyre mjediseve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjeshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë nr. 5 Kamëz, ambienti i sigurisë në tërësi nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrit të

Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, duke mos respektuar kështu standartet ligjore.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisariatit dhe kishte 3(tre) dhoma sigurie, që kishin kapacitet për mbajtjen dhe sigurimin e 3 (tre) personave të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10m² metra dhe jo e ndarë në ambient qëndrimi(dhomë) me sipërfaqe 6m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4m²

Gjithashtu, në fund të korridorit të ambienteve të sigurisë kishte 3 dhoma të tjera, të kyçura me çelës, të cilat shërbenin për njohje e personave në hetim për veprat penale nga organi i prokurorisë apo nga oficerët e policisë gjyqësore në procedimin e një vepre penale. Sipas informacionit nga drejtuesit e institucionit, dhomat e kyçura me çelës administroheshin vetëm nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në këtë mënyrë ishte e pa mundur për inspektim në këto ambiente por pavarësisht se dhomat janë administruar nga DVP Tiranë, administrimi i tyre duhet të jetë i tillë që **Mekanizmi Kombëtar** t’i mundosohet hyrja në të gjitha ambientet që ndodhen brenda mjediseve të shoqërimit dhe sigurisë të këtij Komisarati por edhe Komisariateve të tjera.

Ndërsa në rastin e ndalimit/arrestimit të personave femra dhe të mitur në përfundim të veprimeve procedurale, ata dërgoheshin menjëherë në ambientet e sigurisë në Drejtorinë Vendore Tiranë.

Dritaret e dhomave të sigurisë ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ndërkohë, ndriçimi sigurohej nga rrjeti elektrik në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, në këtë institucion kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Dhomat e sigurisë ishin të pastëra nga ana higjiene -sanitare, por kishte nevojë për lyerje dhe dezinfektim të vazhdueshëm.

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura secila me nga një krevat dhe me furnizim me materiale për fjetje, si dyshek, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra, por mungonin orënditë si tavolina, karrige(stola), për qëndrimin ulur të personave të arrestuar/të ndaluar në këtë institucion.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në dhomat e sigurisë nuk kishte sende që shkaktojnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit, apo që mund të përdoren si mjete për dhunimin fizik të këtyre personave.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një tualet dhe të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larjen dhe pastrimin vetjak dhe në ambientet e dhomave, megjithatë mungonte dushi për larjen e trupit. Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohje/ftohje, sikurse parashikohet në procedurat standarde.

² Kreu V, pika.3.3 e procedurës standarde “trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks për t'u përdorur nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Sikurse në dhoma, mungonte butoni me zile/sinjali, që personat e ndaluar/arrestuar të njoftojnë punonjësit e shërbimit në rast nevojë.

Dhoma për kryerjen e vizitave nga mjeku ishte e përbashkët me dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar nga prokurorët. Gjithashtu, kjo dhomë përdorej edhe për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët. Dhoma ishte pajisur me tavolinë dhe karrige por mungonte krevati për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe rafti për ruajtjen e paketave të ilaçeve për rastet e emergjencave. Këto ambiente, nisur nga funksioni që ato kanë, duhet të jenë të ndara më vete, sikurse përcaktohet edhe në procedurat standarde. Gjithashtu, grupi inspektimit u informua se në rast urgjence të personave të arrestuar/ndaluar i dërgonin në qendrën shëndetësore Kamëz, e cila ndodhej ngjitur me Komisariatit e Policisë nr. 5, Kamëz, Tiranë. Gjatë periudhës 01.01.2021 - 24.05.2021, nga verifikimet e bëra ishte vetëm një rast kishte marrë shërbim shëndetësor në Qendrën Shëndetësore Kamëz.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatit e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, "Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar" ishte i tipit "Model nr. 1" konform me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, dt. 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit".

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisariat, të dhënat e tyre evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga kqyrja e këtij regjistri, rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhet me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, që në momentin kur atyre ju privohej liria.

Nga kqyrja e librave të evidentimit të personave të ndaluar/arrestuar dhe procesverbaleve, nuk kishte mospërputhje mes kohës (orës)kur ishin ndaluar apo arrestimit, me orën e shënuar në procesverbalin e arrëstitimit në flagrancë.

Ndërkohë, Komisariatit kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.1008/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, por për vitin 2021 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e këtyre personave.

Në ambientin e sigurisë, mbaheshin edhe regjistrat dhe librat e tjerë sikurse janë të parashikuara në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07 2019, të cilët ishin të plotësuar sipas rubrikave dhe ishin të sekretuar.

Nga inspektimi, u konstatua se komisariati nr. 5 Kamëz, Tiranë, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit dhe ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisariateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin.³

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në ambientin e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë nr. 5 Kamëz nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodhej një person i ndaluar, si person në kërkim.

Grupi i monitorimit intervistoi personin e ndaluar, i cili konfirmoi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Shtetasi i intervistuar kishte dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe kishte kryer veprimet proceduriale. Ai deklaroi se, gjatë shoqërimit dhe ndalimit nga punonjësit e policisë, ata ishin identifikuar duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrat që kryenin.

Nga i intervistuari nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e tij ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Koha e qëndrimit të personit të arrestuar në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë me shërbim katering, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Ndonëse në ambientin e sigurisë nuk kishte ambiente kulturi, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë ose në ambientin e ajrimit.

³ ligjin nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë, kishte një dhomë që shërbente për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e organit të prokurorisë, njëkohësisht dhe për takime me avokatët. Dhoma ishte e pajisur me tavolina dhe karrige të fiksuara në dysHEME, dritarja ishte siguruar me rrjetë hekuri, por që nuk monitorohej me sistemin audio-viziv të kamerave.

Ndërsa shtetasit e shoqëruar në mjediset e policisë, para se t'u komunikohesh masa e sigurisë dhe të kalonin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së tyre. Kjo praktikë nuk është në përputhje me parashikimet ligjore dhe duhet të ndërpritet menjëherë nga ana e tyre përse kohë se në komisariatin e policisë ka dhomë intervistimi.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.⁴

Nga monitorimi në disa prej zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore që u ndodhën në këtë komisarjat në kohën e inspektimit nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarjat ishte krijuar një magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Grupi i inspektimit, evidentoi si një praktikë të mirë në Komisarjatit të Policisë investimin e realizuar me fondet e World Vision në partneritet me organizatën “Nisma për Ndryshim Shoqëror-Arsis”, për krijimin e tre dhomave me një hapësirë miqësore për të miturit, dy dhoma paralele të ndara sipas grupmoshës 0-14 vjeç dhe 14-18 vjeç, dhe një dhomë ku ndodh ndjekja e procesit të intervistimit dhe regjistrimit për të dyja. Këto dhoma ndodheshin në katin e 3 të godinës të Komisarariatit dhe ishin bërë funksionale nga viti 2019. Ato ishin të pajisura me të gjitha orënditë e nevojshme si tavolina, kolltuqe, bibliotekë për libra, postera informues, si dhe ishte e monitoruar me sistemin audio viziv. Në Komisarjatit të Policisë nr.5 Kamëz, ishin trajnuar 2 specialistë vetëm për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve. Dhomat e intervistimit për të mitur ishin funksionale dhe përdorshin për kryerjen e veprimeve procedurale të intervistimit të miturve në konflikt me ligjin.

MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët, realizohen në një ambient të përshtatshëm i cili është i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e

⁴ Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu kjo kërkon një regjistër të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje elektrike (audio dhe video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste. CPT reports; Armenia: visit 2010 visit 2010 [par.18

bisedave më të miturit, pasi nga intervistimi i tyre në kushte dinjitoze shmanget dhe parandalohet traumatizimi i tyre.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në Komisarriatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Nga inspektimi, rezultoi se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Njëkohësisht u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr. P, që personit të ndaluar/arrestuar duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Gjatë inspektimit u konstatua se, personat e ndaluar/arrestuar madhor ishin njoftuar që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, të kërkonin ndihmë juridike për t’ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte afishuar në ambientin e punës të përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarriatin nr.5 Kamëz Tiranë, u konstatua se ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar.

Ndërsa për shtetasit e huaj të ndaluar/arrestuar, ishin përgatitur deklaratat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-në gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe gjuhës së komunitetit rom.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologu ofrohej nga DVP Tiranë ose nga shkollat e mesme të qytetit. Sipas verifikimeve të kryera, kjo procedurë ishte zbatuar dhe gjatë protestave të zhvilluara në Tiranë.

Personave të ndaluar/arrestuar iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të kartës me të drejtat e tyre. Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë u konfirmua edhe nga intervista me personin që ndodhej në ambientin e sigurisë gjatë kryerjes së inspektimit, i cili sqaroi se dhënia e kartës me të drejtat e tyre ishte bërë në momentin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore.

Grupi inspektues konstatoi gjithashtu se, vizitat mjekësore të personave të arrestuarit/ndaluarit bëheshin nga ana e mjekut/ndihmësmjekut të DVP Tiranë, brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të arrestuar/ndaluar”. Gjithashtu, na informuan se për raste urgjente personat e

ndaluar/arrestuar i dërgonin në klinikën spitalore Kamëz, e cila ishte ngjitur me Komisarlatin e Policisë nr.5, Kamëz Tiranë.⁵

Mjeku ishte i punësuar pranë Drejtorisë DPV Tiranë me kohë të plotë. Ai i pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar, sipas procedurave standarde dhe rekomandimit të CPT-së në këtë pikë.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e ambienteve të sigurisë sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin Nr.925 datë 18.07.2019 të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për të rritur, femra dhe të mitur.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në të gjitha mjediset e Komisarlatin të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me dushe në ambientin e sigurisë të Komisarlatin të Policisë nr.5 Kamëz, për larje të trupit të personave të ndaluar/arrestuar në këtë Komisarlat.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar në dhomën e intervistimit dhe evindetimin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së tyre.
5. Marrjen e masave të nevojshme në Komisarlatin e Policisë Nr.5, Kamëz, për sigurimin e kushteve të përshtatshme të qëndrimit dhe jetesës normale të shtetasve të ndaluar/arrestuar, që të plotësojnë standardin e trajtimit njerëzor e dinjitoz të parashikuar nga Konventa, pajisjen e dhomave të sigurisë me tavolinë, karrige brenda kapacitetit të tyre fizik, si dhe lyerjen dhe dezinfektimin e ambientit të sigurisë.
6. Marrjen e masave për instalimin e sistemit të ngrohjes me kaldajë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarlatin të Policisë nr.5 Kamëz dhe vënien e tij në funksionim në periudhën e dimrit, sipas urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të

⁵ Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar.

Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”.

7. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin në dhomat e sigurisë të sistemit (buton dhe zile) për njoftimin e punonjësve të policisë nga të arrestuarit/ndaluarit në rast nevoje dhe vendosjen e aparatit telefonik fiks dhe citofon në korridorin e ambientit të sigurisë për t’u përdorur nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, të kompletuar me orenditë e nevojshme, si dhe frigorifer për ruajtjen dhe sigurimin e medikamenteve.
9. Marrja e masave të menjëhershme për dhënien një kopje të kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në Komisaratin nr.5, Kamëz, Tiranë.
10. Marrjen e masave të nevojshme për afishimin në ambientet e brendshme të institucionit, si dhe në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, të rregullave të përgjithshme për parandalimin e COVID-19, sipas protokollit shëndetësor për këtë qëllim.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA